



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC
PLANI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIT 2026

Objektivat	Aktiviteti	Treguesit e verifikueshëm	Rreziqet dhe supozimet	Periudha kohore
Përpilimi dhe shqyrtimi i draft planit të punës për vitin 2026.	Takim me të gjithë anëtarët e komitetit për komunitete me qëllim të përpilimit dhe shqyrtimit të planit të punës si dhe arritja e pajtueshmërisë për orarin e takimeve për vitin 2026.	Thirrja e takimit dhe diskutime rreth planit të punës; Përpilimi i draftit të planit të punës.	Mos thirrja e takimit; Mosgatishmëria e anëtarëve të komitetit për t'u angazhuar në përpilim të planit të punës.	Maj -Qershor 2026
Miratimi i planit të punës për vitin 2026 dhe përpilimi i raportit vjetor të punës për vitin 2027.	Finalizimi i planit të punës 2026 dhe raportit për vitin 2027.	Plani i punës për vitin 2026 dhe raporti i punës për vitin 2026 të miratuar nga KK.		Janar 2027
Përcjellja dhe shqyrtimi i rregullt i punës dhe veprimeve të organeve komunale dhe përpilimi i rekomandimeve në mbrojtje dhe promovim të drejtave të komuniteteve	Shqyrtimi i pajtueshmërisë së të gjitha akteve normative, politikave, praktikave të kuvendit komunal me qëllim të sigurimit se të drejtat dhe interesat e komuniteteve mbrohen në tërësi.	Mbajtja e takimeve të rregullta të Komitetit për Komunitete (minimum 6 takime në vit), me qëllim shqyrtimin e akteve normative komunale, sipas nevojës. Organizimi i deri në 2 takimeve me karakter urgjent gjatë vitit, në varësi të çështjeve që kërkojnë trajtim të menjëhershëm.	Mos thirrja e takimeve me rregull; Mungesa e kuorumit në takime;	Qershor-Dhjetor 2026
	Ngritja e çështjeve relevante si dhe përgatitja dhe adresimi i rekomandimeve në mbrojtje dhe promovim të të drejtave të komuniteteve pranë organeve të komunës (KK, Drejtori përkatëse, Kryetar).		Mos gatishmëria e anëtarëve të komitetit për komunitete që t'i ngritin çështjet tek organet komunale. Mungesa e interesimit të organeve relevante për trajtim dhe marrje parasysh të rekomandimeve.	Qershor-Dhjetor 2026

Vizitë vendbanimeve dhe shkollave ku jetojnë komunitet jo shumicë	Vizitë vendbanimeve ku jetojnë komunitet Serb, Ashkali, Egjiptian dhe atij të Romëve me qëllim të diskutimit dhe identifikimit të problemeve me të cilat këta banorë ballafaqohen	Numri i vizitave në terren (së paku 2 vizita në vit); Lista e problemeve të identifikuar gjatë vizitave në komunitetet jo-shumicë.	Mungesa e interesimit të anëtarëve të komitetit për kryerje të vizitave	Qershor-Dhjetor 2026
	Vizitë shkollave me nxënës të komuniteteve Serb, Ashkali, Egjiptian dhe Romë. Takim në teren me drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme.	Numri i shkollave të vizituara	Mungesa e interesimit të anëtarëve të komitetit për kryerje të vizitave; Mungesa e gatishmërisë së drejtorëve për takim.	Qershor-Dhjetor 2026
Takime me drejtorë të departamenteve të ndryshme	Të ftohet drejtori i drejtorisë së shërbimeve publike në takimin e radhës së komitetit për të raportuar lidhur me projektet për kapitale në infrastrukturë ,ndriqim, kanalizim etj , në lagjet e banuara nga komunitetet pakicë gjatë vitit 2026	Mbajtja e takimit dhe raporti i përgatitur nga drejtorja e shërbimeve publike	Mosgatishmëria e drejtorisë për takim.	Qershor-Dhjetor 2026
	Të ftohet Drejtori i Financave që të raportojë për Kornizën komunale buxhetore – Shqyrtimi i mundësisë për ndarjen e buxhetit për nevojat e identifikuar gjatë vizitave në vendbanimet e banuara me komunitetet jo shumicë.	Mbajtja e takimeve dhe raportet e drejtorisë së financave	Mosgatishmëria e drejtorisë për takim.	Qershor-Dhjetor 2026

	Të ftohet drejtori i drejtorisë së arsimit në takimin e radhës së Komitetit për Komunitete lidhur me temën regjistrimi i nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme për vitin shkollorë 2026/27 dhe masat për parandalim të braktisjes së mësimi nga nxënësit e komuniteteve Ashkali, Egjiptian dhe Romë.	Mbajtja e takimit dhe raporti i përgatitur nga drejtorja e arsimit	Mosgatishmëria e drejtorisë për takim.	Qershor-Dhjetor 2026
	Të ftohet Drejtori i Drejtorisë për Kulturë që të marrë pjesë në takimin e radhës të Komitetit për Komunitete, ku do të diskutohet programi i aktiviteteve për periudhën 2026, me fokus në komunitetet jo-shumicë. Manifestimi I ditët nacionale të komuniteteve jo-shumicë, mbështetjen me subvencione për të rinjtë, grupet joformale dhe OJQ-të e komuniteteve, si dhe përkrahjen e aktiviteteve sportive përmes turneve me pjesëmarrjen e të rinjve, dhe mbështetjen e autorëve letrarë nga komunitetet jo-shumicë.	Mbajtja e takimeve dhe raportet e drejtorisë së financave	Mosgatishmëria e drejtorisë për takim.	Qershor-Dhjetor 2026
	Të ftohet Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi që të marrë pjesë në takimin e radhës të Komitetit për Komunitete, ku do të diskutohet programi i aktiviteteve në fushën e shëndetësisë për periudhën 2026, me fokus në komunitetet joshumicë. Rendi i ditës përfshin procesin e imunizimit të fëmijëve nga komunitetet, si dhe mundësi për realizimin e fushatave sensibilizuese në fushat jetike të shëndetësisë, përfshirë shëndetin gjinekologjik, mamografinë dhe sëmundjet kronike .	Mbajtja e takimeve dhe raportet e drejtorisë së financave	Mosgatishmëria e drejtorisë për takim.	Qershor-Dhjetor 2026

	Të ftohet Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi që të marrë pjesë në takimin e radhës të Komitetit për Komunitete, ku do të diskutohet programi i aktiviteteve në fushën e bujqësisë për periudhën 2026, me fokus në komunitetet joshumicë. Rendi i ditës përfshin informata për mbështetjen me subvencione dhe grante për fermerët nga komunitetet joshumicë, furnizimin me inpute bujqësore (fara, plehra, pajisje), organizimin e trajnimeve dhe këshillimeve profesionale për zhvillimin e bujqësisë, si dhe mbështetjen e projekteve për zhvillim rural dhe vetëpunësim.	Mbajtja e takimeve dhe raportet e drejtorisë së financave	Mosgatishmëria e drejtorisë për takim.	Qershor-Dhjetor 2026
	Të ftohet Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik që të marrë pjesë në takimin e radhës të Komitetit për Komunitete, ku do të diskutohet programi i aktiviteteve për periudhën 2026, me fokus në fuqizimin ekonomik të komuniteteve joshumicë.	Mbajtja e takimeve dhe raportet e drejtorisë së financave	Mosgatishmëria e drejtorisë për takim.	Qershor-Dhjetor 2026
Respektimi dhe përdorimi i gjuhëve zyrtare në institucionet publike lokale.	Mbajtja e një takimi me Ekzekutivin e komunës dhe me zyrtarët komunal të administratës, me qëllim të njoftimit mbi zbatueshmërisë së dy gjuhësisë .	Implementimi i ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare.	Mos gatishmëria e anëtarëve të komitetit për komunitete që t'i ngritin çështjet tek organet komunale. Mungesa e interesimit të organeve relevante për trajtim dhe marrje parasysh të rekomandimeve.	Qershor-Dhjetor 2026

Zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Qeverisë për integrimin e komuniteteve rom dhe në shoqërinë e Kosovës, 2026-2029	Takime të rregullta me KKV-ën, siç është paraparë me strategjinë përkatëse, për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Qeverisë për integrimin e komuniteteve rom, dhe Ashkali në shoqërinë kosovare, 2026-2029.	Takime të rregullta me të gjitha mekanizma lokale në komunë me qëllim të adresimit të sfidave rreth implementimit të planit të veprimit	Mos ndarja e buxhetit për implementimin e planit të veprimit për integrimin e komuniteteve rom, Ashkali dhe egjiptian në shoqërinë e Kosovës, 2026-2029.	Qershor-Dhjetor 2026
	Takime konsultative me komunitetet rom dhe Ashkali për identifikim të prioritetëve për vitin 2026 Avokim për ndarje të buxhetit dhe monitorim të zbatimit të strategjisë përkatëse.			
Shqyrtimi i raporteve të organeve relevante komunale	Shqyrtimi vjetor i raportit të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim	Numri i raporteve të dorëzuara te Komiteti për Komunitete dhe pjesëmarrja e zyrtarit në takime	Mos dërgimi i raporteve dhe mungesa e zyrtarit në takimet Komitetit për Komunitete.	
	Shqyrtimi i raportit dhe planin e punës për Komisionin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)	Draft raporti i dorëzuar tek anëtarët e komitetit	Mungesa e draft raportit	Janar-dhjetor 2021
Përgatitja e raportit të punës për vitin 2026 dhe planit të punës për vitin 2027.	Shqyrtimi, analizimi dhe aprovimi i raportit vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2026 dhe hartimi i planit të punës për vitin 2027.	Draft raporti për vitin 2026 dhe draft plani i punës për vitin 2027.	Mosgatishmëria e anëtarëve të komitetit për përpilim të raportit dhe planit të punës	Dhjetor 2026

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.142/26
Datë:29.05.2026

Fatmir Iska
Kryesues i Kuvendit

